



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT

Nr. 859 prot.

Tiranë, më 21.06.2021

V E N D I M

Nr. 1, datë 15.06.2021

PËR

**MIRATIMIN E RAPORTEVE TË VLERËSIMIT PARAPRAK TË RREZIQEVE NGA PËRMBYTJET PËR BASENET UJORE DRIN-BUNË, MAT, ISHËM, ERZEN, SHKUMBIN, SEMAN, VJOSË DHE SHPALLJEN E ZONAVE KU EKZISTON RREZIKU POTENCIAL NGA PËRMBYTJET OSE KA GJASA TË NDODHIN PËRMBYTJE**

Në mbështetje të pikave 6, 7, të Kreut 1, të Shtojcës III, të vendimit nr.1015, datë 16.12.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përmbajtjen, zhvillimin dhe zbatimin e strategjisë kombëtare të menaxhimit të burimeve ujore, të planeve të menaxhimit të baseneve ujore dhe planeve të menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet”, pikës 1, të kreut III, të vendimit nr.221, datë 26.4.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli Kombëtar i Ujit

V E N D O S I:

1. Miratimin e raportit të vlerësimit paraparak të rreziqeve nga përmbytjet për basenin uJOR Drin-Bunë, sipas aneksit I dhe shtojcave 1, 2 të këtij aneksi, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.
2. Miratimin e raportit të vlerësimit paraparak të rreziqeve nga përmbytjet për basenet ujore Mat, Ishëm, Erzen, Shkumbin, Seman, Vjosë, sipas aneksit II dhe shtojcës 1 të këtij aneksi, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.

3. Shpalljen e zonave ku ekziston rreziku potencial nga përmbytjet ose ka gjasa të ndodhin përmbytjet për basenet ujore Drin-Bunë, Mat, Ishëm, Erzen, Shkumbin, Seman, Vjosë, sipas aneksit III, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
4. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore, bashkitë, Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, Agjencia e Zhvillimit të Territorit, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Agjencia Kombëtare e Ujësjellës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve, Agjencia Kombëtare e Pyjeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**ZËVENDËSKRYEMINISTRI**

**ERION BRACE**



**AGJENCIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE UJORE  
DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

**GERTA LUBONJA**